



RREGULLORE NR. 2005/21

**MBI SHPALLJEN E LIGJIT PËR REGJISTRAT E GJENDJES CIVILE TË
MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) të datës 10 qershor 1999,

Në pajtim me kapitullin 8 dhe nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh komunikatën e lëshuar nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës të datës 21 tetor 2004 lidhur me Ligjin mbi regjistrat e gjendjes civile, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 27 shtator 2004,

Duke konstatuar se dispozitat e Ligjit nuk cenojnë autorizimin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas RKSKB 1244 (1999) apo pushtetin e tij të rezervuar dhe përgjegjësitë sipas nenit 8.1 (z) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, si dhe legjislacionin e UNMIK-ut në fuqi në lëmin e regjistrimit civil, veçanërisht Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/13 të datës 17 mars 2000 mbi regjistrimin qendror civil,

Me anë të kësaj shpall Ligjin (Ligji nr. 2004/46) të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, i cili i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje, e që bëhet i plotfuqishëm në ditën e nëshkrimit, me kusht që:

- (a) Titulli i Ligjit të ndryshohet si vijon: “Mbi regjistrat e gjendjes civile”;
- (b) Fjalët “regjistra civil” dhe “ofiçar civil” të zëvendësohen në tërë tekstin me “regjistra të gjendjes civile”, përkatësisht me “ofiçar të gjendjes civile”;

- (c) Përdorimi i simboleve zyrtare në dokumente të gjendjes civile të jetë në pajtim me nenin 1.7 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë;
- (d) Neni 4.3 të zbatohet në pajtim me Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/43 të datës 27 korrik 2000 mbi numrat, emrat dhe kufijtë administrativë të komunave dhe me Urdhëresën administrative nr. 2004/23 për zbatimin e Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/43;
- (e) Në nenin 8.4, fjalët në kllapa “në alfabetin latin” të fshihen;
- (f) Nenet 16.8 (h) dhe 37 (f) të ndryshohen si vijon: “shtetësi/banim i përhershëm”;
- (g) Në nenin 23, fjala “jashtë” në titull të zëvendësohet me “jashtë Kosovës”;
- (h) Neni 23.1 të ndryshohet si vijon: “Prindërit të cilët janë banorë të përhershëm të Kosovës mund ta regjistrojnë lindjen e fëmijës së tyre të lindur jashtë Kosovës në zyrën e gjendjes civile të komunës ku ata kanë banim të përhershëm”;
- (i) Fjalët “shtet i huaj” në nenin 23.3 të zëvendësohen me “autoritete kompetente jashtë Kosovës”;
- (j) Në nenin 33.4, fjala “shtet” të zëvendësohet me “Kosovë”;
- (k) Në nenin 43, titulli “Dispozitat ndëshkuese” të zëvendësohet me “Sanksione administrative dhe procedura disiplinore”;
- (l) Nenet 43.2 dhe 43.4 të fshihen dhe
- (m) Fjalët “qytetar(ët) i/e Kosovës” të fshihet dhe të zëvendësohet në tërë tekstin me “banor(ët) e përhershëm të Kosovës”.

Ndryshimet në (a), (b) dhe (e) deri në (m) do të paraqiten në tekstin përfundimtar zyrtar të Lijgit.

Nënshkruar sot, më 7 maj 2005.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm